



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
PËR VITIN 2022**

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Vlera e pasurisë kapitale e prezantuar në PFV ishte mbivlerësuar për 497,941€ si rezultat i mos bartjes së pronësisë së projekteve kapitale pas përfundimit tek komunat përkatëse, si dhe për shkak të mos zhvlerësimit të disa pasurive nën 1,000€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në

përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 MAPL në dy raste punët/furnizimet të pranuar nuk ishin në përputhje me specifikat e kontratave, po ashtu në një rast kishte vonesa të theksuara në realizimin e punëve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të

ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në vitin 2022 MAPL kishte shpenzuar 5,060,469€ apo rreth 65 % të buxhetit me një performance jo të kënaqëshme, të ngjashme në krahasim me vitin 2021 ku realizimi i buxhetit ishte në nivel 64%.

Fushat që kërkojnë veprime të menjëhershme për shkak të ndikimit të tyre në PFV janë menaxhimi dhe mirëmbajtja e regjistrave të pasurive si dhe bashkëpunimi me komunat për bartjen e pasurisë. Po ashtu, veprime duhet të ndërmerren edhe tek monitorimi i subvencioneve dhe transfereve, mbyllja e avanceve si dhe tek menaxhimi i projekteve.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja dhe dy (2) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mbivlerësim i pasurisë në PFV

Gjetja

Neni 13 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj". Po ashtu memorandumet e bashkëfinancimit të lidhura në mes të ministrisë dhe komunave përcaktojnë që me pranim dorëzimit e punëve të kryera nga OE projekti do të kaloj në pronësi të komunës. Më tutje, neni 22 paragrafi 3 i po të njejtës rregullore përcakton se: Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.

Vlera e prezantuar e pasurisë në PFV ishte mbivlerësuar për 497,941€, në këtë kanë ndikuar⁵:

- Nëntë (9) projekte të bashkëfinancuara me komuna në vlerë totale prej 495,727€ të cilat edhe pse ishin përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik i tyre nga komisionet përkatëse, ato vazhdojnë të figurojnë në regjistrin e ministrisë si investime në vijim, duke e mbivlerësuar vlerën e pasurive kapitale; dhe
- Si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit të pasurive nën 1,000€ për nëntë (9) raste, vlera e pasurive ishte mbivlerësuar për 2,214€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos kordinimit ndërmjet zyrtarëve të

ministrisë dhe atyre të komunave përkatëse si dhe mos aplikimit të normave të zhvlerësimit në sistemin e-pasuria.

Ndikimi

Mos bartja e pronësisë së pasurive tek komunat përkatëse si dhe mos aplikimi i zhvlerësimit të pasurive jo kapitale ndikon në paraqitje jo të drejtë dhe mbivlerësim të vlerës së pasurisë në PFV.

Rekomandimi B1

Ministri përmes departamentit të monitorimit të komunave duhet të siguroj një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës të ministrisë dhe atyre të komunave, në mënyrë që të gjitha projektet e përfunduara përmes bashkëfinancimit për komuna të barten në regjistrat e tyre dhe njëkohësisht të azhurnohet regjistri i ministrisë. Po ashtu, të sigurojë se aplikohet zhvlerësimi i të gjitha pasurive jo-kapitale me qëllim të paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në realizimin e punimeve nga bashkëfinancimet me komuna

Gjetja

MAPL bazuar në Ligjin e Buxhetit 2022, kishte lidhur Marrëveshje Bashkëfinancimi për Programin për Mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete me komunat e Republikës së Kosovës. Neni 7 i kësaj Marrëveshje përcakton që komunat duhet të ndërmarrin të gjitha masat që projekti të përfundojë brenda vitit buxhetor 2022. Në anën tjetër, përgjegjësitë e secilës palë, duke përfshirë edhe përfundimin e punëve brenda vitit 2022, parashihen në kontratat publike në mes të komunave përkatëse me operatorët ekonomik, bazuar në marrëveshjet e nënshkruara nga ana e MAPL me komunat përkatëse.

Nga testimi i 28 mostrave për bashkëfinancime me komunat përkatëse, vetëm dhjetë (10) pagesa lidhur me tetë (8) projekte ishin përfunduar brenda afatit, ishin bërë pranimet teknike dhe MAPL kishte bërë kërkesa për fshirjen/ bartjen e pasurisë në komunat përkatëse. Përderisa, për 18 projektet tjera, pagesat nga ana e MAPL-së ishin përfunduar në anën tjetër komunat përkatëse nuk i kishin kryer obligimet e tyre financiare.

Ne kemi identifikuar një (1) rast ku punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik, siç parashihej me kontratë. Ndërtimi i murit rrethues në shkollën fillore "Asdreni" dhe "Xhemajl Kada" në Pejë - vlera e kontratës 53,099€, vlera e financuar nga MAPL ishte 40,000€, përderisa vlera e financuar nga Komuna e Pejës ishte 13,099€. Kontrata ishte nënshkruar me 28.07.2022 me afat për përfundim për 60 ditë kalendarike, ndërsa fatura lidhur me situacionin fillestar ishte pranuar me 15.11.2022 në vlerë prej 16,684€. Bazuar në Raportin e menaxherit të kontratës të datës 20.10.2022 ceket që punët kanë filluar dy javë pas nënshkrimit të kontratës, për arsye të kushteve atmosferike dhe disa problemeve tjera, përderisa nga mbikëqyresi i punëve në raport nuk ceket asnjë pengesë gjatë ekzekutimit, edhe pse kishte vonesa në ekzekutimin e punëve. Deri në prill të vitit 2023 përqindja e realizimit të projektit ishte 59.64%.

Ndërsa, në dy (2) raste punimet nuk ishin realizuar në përputhje me specifikat e theksuara në kontratë:

- Gjatë ekzaminimit fizik, për kontratën 'Furnizim me pajisje për nevojat komunale - furnizim me kamiona dhe kamioneta për pastrimin e rrugëve' nga skema e grantit të performancës komunale, Komuna e Obiliqit (në vlerë 203,850€ dt.21.10.2022) për kemi evidentuar që ka mospërputhje në mes të kontratës dhe furnizimeve. Diferencat e evidentuara janë si në vijim: 1) motori i kamionit i kontraktuar me lëndë djegëse dizel, ndërsa ishte pranuar me benzin, 2) kërkesa ishte që motori duhet të jetë me së paku kubikazhi 2.8 kuaj fuqi, ndërsa ishte pranuar me 1.5; 3) pesha bartëse jo më pak se 1500 kg, ishte pranuar pesha bartëse 935 kg; 4) pesha totale e kamionetës nuk duhet të tejkaloj peshën 3500 kg, ndërsa u pranua pesha totale e kamionetës prej 1380 kg; 5) kërkesa ishte me goma duplikat (dyfish) në boshtin prapa, ndërsa ishte pranuar me goma tek dhe 6) xhamat e dyerve duhen me qenë elektronik, ndërsa ishin pranuar xhamat e dyerve jo elektronike (mekanike).

Deri në ekzaminimin fizik këto pajisje qëndronin në depo, me arsyen e mosregjistrimit nga komuna.

- Ndërtimi i rrugës Riza Krasniqi në Breznicë - Komuna e Obiliqit, (DEMOS) - vlera e kontratës 164,449€, vlera e financuar nga MAPL ishte 150,000€, përderisa nga Komuna e Obiliqit ishte 14,449€. Sipas kontratës ishin paraparë të vendosen 40 puseta, ndërsa ishin vendosur 28 puseta. Po ashtu, kishte ndryshime në pozicionimin e urave, trasesë së kanalizimit, për shkak të projektimit jo sipas nevojave të terrenit, si dhe ndërrim të materialit. Këto ndryshime janë bërë me aprovim paraprak nga menaxheri i kontratës

Kjo sipas MAPL kishte ndodhur për shkak të vonesave në shpalljen e komunave përfituese nga Granti i performances, pas të cilëve ishin nënshkruar Marrëveshjet e mirëkuptimit si dhe vonesave në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga komunat.

Ndikimi

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që MAPL të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe njëherësh mund të shkaktoj vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë që përmes stafit përkatës të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të papërfunduara. Më tutje, të ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që punimet të realizohen sipas planit dinamik të kontraktuar. Po ashtu, në bashkëpunim me komunat përkatëse duhet të sigurojë se para inicimit të procedurave tenderuese të kryhen analiza të detajuara për projektet përkatëse në mënyrë që realizimi i tyre të mos pësojë ndryshime prej planit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2022 ishte 1,009,284€, ndërsa prej tyre ishin shpenzuar 575,346€. Ato kanë të bëjnë me shërbimet kontraktuese, avanse për udhëtime zyrtare, dreka zyrtare etj.

Çështja A2 - Tejkalimi i vlerës së kontratës kornizë

Gjetja

Ligji Nr. 04/ L-042 (me plotësim ndryshimet) për prokurimin publik, neni 38, parasheh se “Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit. Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër-blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%) pa marrë parasysh datën origjinale të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht”.

MAPL kishte tejkalluar për 975.18 litra mbi normën e lejuar + 30% vlerën e furnizimeve të kontraktuara sipas sasisë së parashikuar për 3 vite, shprehur në vlerë monetare për 1,658€.

AQP me datë 12.07.2019 kishte lidhur Kontratë publike kornizë për "Furnizim me Karburant" (benzin dizell) LOT III, ku përmes kësaj kontrate AQP për MAPL –në ishte parashikuar shpenzim total të derivateve prej 30.000 litra për tre (3) vite.

Kjo kishte ardhur si rezultatit i një mbikëqyrje të dobët të ecurisë së realizimit të kontratës nga menaxheri i kontratës.

Ndikimi

Tejkalimi i kontratës mbi normën e lejuar mund të ndikojë që organizata buxhetore të hyjë në obligime financiare të pa planifikuara duke rritur shpenzimet e ministrisë.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e realizimit të kontratave, në mënyrë që të parandalohen tejkallimet e furnizimeve nga sasia e kontraktuar. Në rastet kur tejkallimi i kontratës arrin shkallën +30%, të mos bëhen porosi të reja.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mbulimi i pozitës së rregullt me marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV)**Gjetja**

Neni 3, pika 1 i Rregullës për prokurim të shërbimeve të veçanta përcakton që: "Shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbime profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë por nuk i plotëson kërkesat me stafin që e ka. Më tutje, neni 47.26 i Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), përcakton që "Në qoftë se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, autoriteti kontraktues ka përcaktuar kriteret e dhënies "Tenderi ekonomikisht më i favorshëm", dhënia e tillë do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshës së kriterëve që janë specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Këto kriteret duhet të përputhen me nenin 52 të LPP-së të përmbushin kërkesat e mëposhtme: 1. Kriteret duhet të jenë të matshme, që në esencë do të thotë se ata duhet të jenë mjaft konkrete dhe të qartë për të mundësuar që të vlerësohen tenderët në raport me njëri-tjetrin".

MAPL gjatë vitit 2022 kishte lidhur kontratë për shërbime të veçanta për angazhimin e një Konsulenti për menaxhimin e projekteve për investime kapitale, në vlerë prej 25,600€ me kohëzgjatje prej tri (3) vitesh.

Përkundër, që Departamenti për Monitorim i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP)-së kishte rekomanduar që "Këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrat Publik nr. 06-L-114 dhe e kishte rekomanduar MAPL-në të vlerësoj edhe njëherë se: Aktiviteti i prokurimit, a është në përputhje me rregulloren për shërbime të veçanta dhe me njoftimin e KRPP-së të datës 02.02.2021. Megjithatë, MAPL kishte nënshkruar kontratë afatgjatë me konsulentin (2022-2025) edhe pse kjo pozitë mund të plotësohet pas rekrutimit të stafit në vitet në vijim. Për më tepër, bazuar në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm në MAPL ekziston pozita e buxhetuar për Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Projekteve dhe Zyrtar i Lartë për Zhvillim dhe Monitorim të Zbatimit të Projekteve, pozita të cilat janë ende të lira.

Gjatë testimit, ne kemi evidentuar që edhe në procedurën e zhvilluar të prokurimit për këtë pozitë, kriteret e përcaktuara në disa raste nuk ishin konkrete dhe të qarta. Raporti i vlerësimit nuk përcakton qartë vlerësimin bazuar në poentim dhe peshë sipas kriterëve specifike për të mundësuar krahasimin e ofertave. Në këtë raport ishte evidentuar vetëm ekzistenca e dëshmive por jo edhe poentimi.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos planifikimit të duhur të personelit në harmoni me nevojat e institucionit.

Ndikimi

Kjo ndikon në ngarkimin e buxhetit për mallra dhe shërbime duke krijuar shpenzime shtesë për ministrinë si dhe mos vlerësimi/poentimi bazuar në kriteret për kontraktimin e konsulentit për një fushë specifike nuk siguron vlerë për Ministrinë.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të sigurojë që pozitat të cilat i ka të aprovuara me ligj të buxhetit plotësohen përmes procedurave të rekrutimit. Aplikimi i procedurave për MSHV të bëhet vetëm për mbulimin e pozitave specifike, përmes kriterëve të paracaktuara të matshme dhe konkrete.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Avancet e pambyllura nga vitet paraprake

Gjetja Rregulla financiare nr.01/2013 MF- Shpenzimi i parave publike dhe Udhëzimi Administrativ për udhëtime zyrtare nr. MShP 2004/7 përcaktojnë që avancet për udhëtime zyrtare duhet të mbyllen dhe shumat e pashpenzuara duhet të kthehen në llogarinë bankare brenda 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

MAPL, në nenin 20 në Raportin Vjetor Financiar (RVF), kishte paraqitur avance të paarsyetuara për udhëtime zyrtare në vlerë prej 5,762€. Nga kjo shumë, vlera prej 1,670€ ishin avancet e pambyllura nga vitet paraprake (2010-2014), përderisa avance të pambyllura për vitin 2022 ishin në vlerë prej 4,092€.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos koordinimit në mes të zyrtarëve përgjegjës të MAPL-së dhe Thesarit, si dhe mungesës së dokumentacionit lidhur me avancet e viteve paraprake.

Ndikimi Vonesat në mbylljen e avanceve ndikojnë në mos evitimin e gabimeve në llogarinë e avanceve dhe pasqyrojnë shpenzime të pambyllura duke bërë që kjo llogari të figurojë e hapur në vazhdimësi. Po ashtu, informatat e prezantuara në PFV nuk prezantojnë gjendjen reale të avanceve të ministrisë.

Rekomandimi B2 Ministri në bashkëpunim me Thesarin të siguroj se janë marrë masat konkrete për mbylljen e avanceve të hapura bazuar në dokumente mbështetëse, në mënyrë që të evitohet mbivlerësimi i tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	6,652,075	7,799,564	5,060,469	3,871,569	2,931,994
Grante Qeveritare – Buxheti	6,652,075	6,008,308	4,188,076	3,576,725	2,849,013
Donacionet e jashtme	0	1,791,256	872,393	294,844	82,982

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 1,147,489€. Kjo rritje është rezultat i ndarjes së granteve të donatorëve si Fondet e Bashkimit European/ Këshillit të Europës si dhe Bankës Botërore.

Në vitin 2022 MAPL kishte shpenzuar 5,060,469€ apo rreth 65 % të buxhetit me një performance jo të kënaqëshme, të ngjashme në krahasim me vitin 2021 ku realizimi i buxhetit ishte në nivel 64%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	6,652,075	7,799,564	5,060,469	3,871,569	2,931,994
Pagat dhe mëditjet	918,630	1,073,883	897,836	926,987	969,397
Mallrat dhe shërbimet	262,945	1,009,284	575,346	321,568	121,183
Komunalitë	15,500	17,060	5,374	5,005	5,140
Subvencionet dhe transferet	0	806,756	362,515	0	0
Investimet Kapitale	5,455,000	4,892,583	3,219,399	2,618,008	1,836,273


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 155,253€. Ky ndryshim ishte si rezultat i fondeve të alokuara nga Grantet e donatorëve si Instrumenti i Para Anëtarësimit - IPA/ BNK në vlerë prej 86,706€ si dhe alokimit të grantit nga Banka Botërore në vlerë prej 68,546€. Buxheti ishte shpenzuar në nivel rreth 84% i ndikuar nga pamundësia e

mbulimit të pozitive të lira;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 747,899€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit ishte vetëm 57%. Ky realizim është ndikuar nga ristrukturimi i projektit të Bankës Botërore, si dhe ndarjes së buxhetit për tre vite lidhur me projektin IPA/BNK;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 806,755€ pasi nuk kishte mjete të ndara me buxhetin fillestar. Kjo rritje ishte rezultat i projektit të Bankës Botërore. Realizimi i buxheti ishte 45%, në këtë nivel kanë ndikuar vonesat në shpalljet të thirrjeve publike për subvencione në komunat përkatëse;
- Buxheti final për investime kapitale, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 562,417€ Kjo ulje ishte rezultat i ngecjes së investimeve kapitale tek bashkëfinancimet me komuna dhe deklarimit të kursimeve buxhetore. Përkundër uljes së buxhetit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit, vetëm 66 % e buxhetit final ishte shpenzuar. Ky nivel i realizimit ishte ndikuar nga vonesat në shpalljen e përfituesve nga Granti i performancës së komunave, vonesat në vlerësimin e aplikimeve për programin komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal, si dhe vonesat në aprovimin e kriterëve për programin Mbështetja për projektet infrastrukturore për komunitete në Komunat e Republikës së Kosovës.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të MAPL ka rezultuar në katër (4) rekomandime. MAPL kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu, MAPL kishte përgatitur edhe Raportin periodik për implementimin e rekomandimeve të dalura.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, dy (2) rekomandime janë zbatuar dhe dy (2) rekomandime nuk ishin zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri në bashkëpunim me departamentin e monitorimit të komunave duhet të sigurojnë një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës në mënyrë që regjistri i pasurive azhurnohet dhe të gjitha projektet e përfunduara bashkëfinancime për komuna barten në pronësi të tyre. Po ashtu, të sigurojë se aplikohet zhvlerësimi i pasurive jo-kapitale me qëllim të paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF.	Në lidhje me 6 lëndet e gjetura janë dërguar kërkesat për ndërrimin e statusit (fshirje e pasurisë) në MF dhe janë fshirë nga regjistri i pasurisë. Por ne kemi raste të reja të identifikuara Çështja B1	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se të hyrat e realizuara nga donatorët paraqiten/prezantohen saktë dhe drejtë në PFV-të e vitit 2022.	Gjatë vitit aktual ne nuk kemi hasur në gabim të tillë.	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri në bashkëpunim me Thesarin të siguroj se janë marrë masat konkrete për mbylljen e avanceve të hapura bazuar në dokumente mbështetëse, në mënyrë që të evitohet mbivlerësimi i tyre në RVF.	MAPL gjatë vitit 2022 kishte mbyllur avance të viteve paraprake në vlerë 4,177€. Përkundër kësaj vlere e avanceve në fund të vitit 2022 ishte po thuasje e njëjtë me vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja NjAB dhe të sigurohet pavarësia e kësaj njësie.	Komiteti i Auditimit është funksionalizuar.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Neslihane Mati, Udhëheqëse e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mbivlerësim i pasurisë në PFV	<p>Në lidhje më çështjen B1, MAPL jep sqarimet si në vijim:</p> <p>-MAPL në tri (3) raste ka dërguar kërkesën për fshirje të pasurisë me datën 19.01.2023 në MFPT, por nuk janë fshirë nga SIMFK. (argumentet janë dërguar në draftin e parë të raportit).</p> <p>-Në pesë (5) raste MAPL ka kërkuar nga komunat me datat 19 dhe 27 shtator 2022, me datën 11.11.2022 dhe me datën 17.01.2023 të dërgojnë në MAPL pranimet teknike. MAPL nga komunat nuk ka pranuar pranimet këto pranime teknike. MAPL nga komunat nuk ka pranuar këto pranime teknike. Të njëjtat janë pranuar nga ekipi i auditimit 12.04.2023. Nga pesë (5) rastet e pranuar nga ekipi i auditimit 3 janë dërguar për fshirje ndërsa 2 prej tyre nuk ka qenë pranimit teknik I kompletuar/ nënshkruar nga komisioni I pranimit.</p> <p>-Në një rast MAPL ka dërguar një shkresë për MFPT për fshirje të 5 pasurive, prej tyre janë fshirë vetëm 3 ndërsa dy të tjera janë fshirë me 05.05.2023 pas kërkesës së MAPL të datës 03.03.2023 dhe e përsëritur me datën 05.05.2023 (argumentet janë dërguar në draft raportin e parë).</p>	<p>Ministria nuk e konteston të gjeturën dhe konfirmon veprimet që kanë ndërmarrë pas identifikimit të rasteve nga ekipi i auditimit. Të njëjtat nuk ndikojnë gjendjen e paraqitur në raport.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p>
Mangësi në realizimin e punimeve nga bashkëfinancimet me komuna	<p>Në lidhje më çështjen A1, MAPL jep sqarimet si në vijim:</p> <p>- Bazuar në marrëveshjet për mbështetje financiare obligimet e komunave ndër tjerash janë:</p> <p>- Komuna obligohet të zhvillojë projektin në përputhje me këtë marrëveshje dhe kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>- Komuna cakton projekt menaxherin/ organinin mbikqyrës për mbikqyrjen e kryerjes së punimeve dhe komisionin I cili</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëfinancimit me komunat përkatëse përcaktojnë dispozitat përmes të cilave MAPL obligohet të monitoroj projektet në vazhdimësi, dhe përmes monitoruesit të caktuar nga MAPL obligohen të ndërmarrin masa në rast të parregullsive apo defekteve gjatë realizimit të kontratës.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p>

	<p>lëshon certifikantën e punimeve/ pranimit teknik.</p> <p>- Projekt menaxheri/ organi mbikqyrës me përgjegjësi të plotë, vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve/ furnizimeve të kryera, në bazë të të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar (faturën), me kërkesën për realizimin e punimeve/ furnizimeve të kryera, duke iu referuar kushteve të kontratës.</p> <p>- Ndërsa, bazuar në marrëveshjen për mbështetje financiare obligimet e MAPL ndër të tjerash janë:</p> <p>- MAPL nuk mban përgjegjësi në rast të dështimit të projektit për shkaqe të cilat ndërlidhen me autorizimet e saja, si dhe në rast të ndryshimeve të mundshme të çfarëdo natyre ose shkelejev që mund të ndodhin gjatë zbatimit të projekteve që bien në përgjegjësi të komunës (argumentet janë të bashkangjitura).</p>	
<p>Mbulimi i pozitës së rregullt me marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV)</p>	<p>Kjo procedurë/ dosje e tenderit për konsulent/ individ është zhvilluar në harmoni të plotë me LPP- Nenit 22, Neni 52, RRUOPP Neni 9 dhe Neni 10 në të gjitha pikat e saj, gjithëashtu është respektuar edhe ndryshim/ plotësim i rregullave dhe shërbimeve të veçanta (konsulent/ Kontraktor Individual) I publikuar nga KRRPP me datë: 18.11.2020) siç e kërkon kjo rregullore për personat OE-fizik ku kriteret janë vendosur në harmoni të plotë me Nenin 3 Informatat e përgjithshme, Neni 4 Shërbime Konsulente individuale konform pikës 4.8 (referojuni kësaj rregullore e cila është specifikash për shërbime të tilla).</p> <p>Dosja e tenderit është përgatitur dhe publikuar konform, Nenit 27 të LPP-së dhe RRUOPP Neni 18, në dosje është caktuar afat kohorë për sqarim të tenderëve dhe gjatë tenderimit nuk kemi pasur kërkesë për sqarim të dosjes së tenderit Nuk kemi pasur kërkesë për Sqarim të kriterëve që lent ë nënkuptohet se janë të qarta për OE.</p> <p>-person fizik të cilët kanë qen të interesuar të marrin pjesë.</p>	<p>Thirrjet në nenet përkatëse të RrUOPP nga MAPL nuk janë pjesë e të gjeturës përkatëse nga ZKA. Raporti i vlerësimit ishte i mangët pasi kandidatët nuk ishin poentu por vetëm ishte evidentu ekzistenca ose jo e dëshmime të kërkuara.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p>

	<p>Ne kemi vepruar sipas RRUOP Neni 8 ku kemi marr aprovim nga AQP për procedurën në fjalë. Kriteret janë të përcaktuar në dosje të tenderit (mund ti referohuni dosjes në fjalë) si: -Tenderi I përgjegjshëm me Çmimin më të ulët; apo -Tenderi I përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara sipas Aneksit 6 1.Kualifikimet minimale Përgatitja profesionale 30 pikë; Përvoja e punës 50 pikë; Njohuria specifike të fushës 15 pikë; Shkathtësi në komunikim dhe punë 5 pikë; 80% 2.Çmimi 20%.</p>	
--	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministerstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet. Komentet lidhur me gjetjet i gjeni bashkëngjitur kësaj shkresë në kundërt të tabelës për komente.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Elbert Kasnajt

Ministër / Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje:

- Zë. Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së;
- Arkivi të MAPL-së;
- ZKJ, MAPL.

Data: 16 Qershor 2023

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Nënvlersuar për: 1. Motoçikleta VNL 876, 55€ e shitur në ankand; 2. Instalimi i TV-se me kompjuter VNL 40€; 3. kabinet VNL 108,33€; 4. Frigorifer VNL 176,94€; 5. Telefon mobil 273,89€; 6. Telefon mobil 308,95 €; 7. Samsung i9300 VNL 201, 67€; 8. Samsung i9300 VNL 201,67 €; 9. Rafta druri i punuar nga melamini me kualitet të lartë dm 207x100x34x1.6mm VNL 54,08; Mbivlerësuar për: 1.“Rregullimi Urban Dhe Ndrçimi Publik në Fshatrat:Terstenik, Lutogllave Dhe Ruhot”, në vlerë 60 000€, Pranimi Teknik i datës 19.12.2022; 2. “Trotuari Dhe Ndrçimi Publik Shkolla Skenderbeu-Qyshk, Katundi I Ri Dhe Kristal Kk”, në vlerë 50 000€, Pranimi Teknik i datës 22.12.2021; 3. “Ndërtimi i Hapësirave Publike për Rreth Qkmf-së”, në vlerë 40 000€, Pranimi Teknik i datës 12.08.22; 4. “Ndrçimi në Lagjen Dardania 1-Dardania 2, Lagjen E Zabelit Tek Rru. E Valbones, Lagjen Bellopoj, Rr.Shpetim Bojku, Ne Fshatin Novosell, Fshati Ruhote; në vlerë 60,727€, Pranimi teknik i datës 04.05.2022; 5. “Rregullimi I Parkut Karagac”, në vlerë 30 000€, Pranimi Teknik i datës 21.11.2022; 6. “Ndërtimi I Ndrçimit Publik Në Rrugën "Uesli Klark" Në Pejë”, në vlerë 50 000€, Pranimi Teknik i datës 06.12.2022; 7. “Rregullimi i Parkingut dhe Këndit Të Lodrave në Lagjen E Komuniteteve në Fshatin "Gjyrkoc" Komuna e Shtimes, (dy pagesa) në vlerë 50,000€, Pranim Teknik i datës 08.12.2022; 8. Ndërtimi i Ndrçimit Publik dhe Trotuari në shkollën Gjinnazi Bedri Pejani" Në Fshatin Sevek, Bllagejë dhe Nabërgjan - Komuna e Pejës, 90 000 €, Pranim Teknik i datës 08.12.2022; 9. “Ndrçimi Publik në rrugën: Adem Jashari, Rruga Uçk-së dhe Konferenca E Bujanit”, në vlerë 65 000€, Pranimi Teknik i datës 07.12.2021. 10. “Ndërtimi i rrugëve dhe këndit rekreativ në Lagjen e Komuniteteve - Komuna E Rahovecit” në vlerë 40,000€, Pranimi Teknik I Datës 20.12.2022 11. PAISJE TJERA (SIGURIMI I PAISJEVE HARDWERIKE) 69,498€ në vlerë prej 5791€;
- ⁶ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.